



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOVOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria për Prokurim Publik
14 Nr. 1170/23
Dt. 13.10.2023

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. “BD Trade“ sh.p.k. me seli në Skenderaj, kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik për Dhënie të Kontratës të publikuar më dt. 04.10.2023, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 63.1.2 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, më datën 13.10.2023 bie këtë:

V E N D I M

- 1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar Kërkesa për rishqyrtim, e subjektit në procedurë: “BD Trade“ sh.p.k. me seli në Skenderaj, e datës 09.10.2023, për rishikimin - rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit kundër Vendimit mbi Njoftimin e Autoritetit Kontraktues të datës 04.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rregullimi i shtratit të lumit Tërstena, Podrança dhe lumenjëve në Studime dhe Smrekonicë” - Ritenderim me nr. të prokurimit : Nr. Prok: VU644 – 23 – 7150 – 5-1-1 / Nr. i Brendshëm: VU644 – 23 – 070 – 511.**
- 2. Autoritetit Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së dhe nenin 63.1.3 pika (a) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik do të anuloi Vendimin paraprak të ankimuar nga Ankuesi dhe do të vazhdoi me procesin e ri vlerësimit të aktivitetit të prokurimit.**
- 3. Vendimi hyjn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.**

A r s y e t i m

Me vendimin e saj, Autoritetit Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik ka marrë vendim që në aktivitetin e prokurimit: “Rregullimi i shtratit të lumit Tërstena, Podrança dhe lumenjëve në Studime dhe Smrekonicë” - Ritenderim me nr. të prokurimit: Nr. Prok: VU644 – 23 – 7150 – 5-1-1 / Nr. i Brendshëm: VU644 – 23 – 070 – 511.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se A.K. duke vendosur si në Njoftimin për Kontratë e dt. 01.09.2023, ka shkelur dispozitat e LPP-së, konkretisht: nenin 11, 59, 60 dhe 69.

Ankuesi pretendon se:

- 1. AK nuk ka respektuar nenin 71 neni 3.3 ku thuhet: kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrihen arsyet, që bindshëm demonstronjë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik, me këtë rast AK nuk ka gjykim të arsyeshëm dhe bindës, përveç një deklaratë, e që kërkon të ruhet sekreti afarist, ku**

nga kontrolli fizik që kemi bërë, te shumica e punëve janë: kontrata publike dhe të qasshme si dokumente.

2. AK ka shkelur Rregulloren nr. 001/2022 te neni 7 pika 7.6 Informacionet mund të klasifikohen si konfidenciale vetëm nëse: a. Operatori Ekonomik, përveç se i identifikon (“markon”) dokumentet si “sekret afarist” gjatë ngarkimit të tyre në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik, i njëjti duhet të plotësojë Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit “Kërkesa për sekret afarist”. b. Nëse Operatori Ekonomik konsideron që informatat e dorëzuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së të trajtohen nga Autoriteti Kontraktues si informata sekrete afariste në përputhje me nenin 11 të LPP-së, i njëjti duhet të shkarkojë nga sistemi Aneksin 3 “Kërkesa për sekret afarist”, të plotësojë duke dhënë arsyetimet për secilin dokument të identifikuar si “sekret afarist”, nënshkruaj dhe vulos aneksin, si dhe ta ngarkojë në sistem së bashku me dokumentet tjera të tenderit të tij. I njëjti nuk ka të markuar cilat dokumente përbëjnë sekret afarist, si dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim veç e veç siç kërkohet sipas këtij neni, me këtë rast mosdhënia e dokumentacionit na ka zbehur analizën tonë për kërkesën për rishqyrtim.

Pretendimet nr. 1 dhe 2 janë plotësisht të pabazuara, pasi që procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Sipas nenit 1 të LPP-së, A.K. ka pasur për qëllim që, bazuar në kushtet dhe rregullat e specifikuara, procedurën e zbatuar, të siguroj mënyrën më efikase më transparente dhe më të drejtë të realizoi shfrytëzimin e fondeve publike dhe burimeve publike të A.K. Neni 7 ka pasur për qëllim trajtimin e barabartë, pa diskriminuar asnjë prej O.E. pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, neni 33 paragrafi 1 (Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 59 (Ekzaminimi, vlerësimi dh krahasimi i tenderëve) lidhur me nenin 60 paragrafi 1 pika 1.1 (tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët) ka pasur për qëllim, që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i ekzaminimit dhe vlerësimi të tenderëve, të vendosë në mënyrë meritore. Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se Vendimi i A.K. i dt. 09.10.2023 është marrë bazuar në kushtet, rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e Ankuesit se A.K. ka shkelur nenin 11 të LPP-së, pasi që Ankuesit nuk i është lejuar qasja në dokumentet e O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës, A.K. konstaton se një pretendim i tillë i Ankuesit nuk qëndron. Përfaqësuesit të Ankuesit i është lejuar qasja në dokumentet e tenderit të O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës, i njëjti, më dt. 09.10.2023, ka realizuar qasjen e drejtpërdrejtë dhe të papenguar në dokumentet tenderike të O.E. të cilat janë lejuar për qasje, duke marrë dhe kopje të dokumenteve të cilat realizuesi i qasjes i ka konsideruar si relevante dhe të nevojshme për ti pasur në dispozicion.

Si përfundim, A.K. konstaton se procesi i qasjes në dokumente, mbi bazën e Kërkesës për qasje në dokumente tenderike është zhvilluar konform dispozitave ligjore të LPP-së dhe Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, që rregullojnë këtë çështje, andaj mbi këtë bazë A.K. vlerëson se Kërkesa e O.E. për qasje në dokumente tenderike është realizuar dhe / ose përfunduar në pajtim me dispozitat e LPP-së dhe Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

3. AK nuk ka respektuar Nenin 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, ku thuhet Autoriteti Kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. Në këtë rast autoriteti kontraktues përmes sqarimeve ka ndërruar liderin e grupit, ky fillimisht sipas dorëzimit të ofertave ka qenë Grandelite llc, më pas AK përmes letrës standarde jashtëligjshëm ka kërkuar informata shtesë, me këtë rast është ndërruar lideri, ku është vendosur Udha shpk.

Ky pretendim është plotësisht i bazuar.

4. AK nuk ka respektuar nenin 69 pika 4,2 listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë

sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkrura nga autoriteti i tillë publik: (i) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë, me këtë rast me qenë se sipas marrëveshjes fillestare të konzorciumit lideri Grandelite llc nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit, ku duhet të ketë 60 % të vlerës totale prej 700,000.00 €.


Ky pretendim është plotësisht i bazuar.

Pasi u shqyrtuan pretendimet e Ankuesit të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim dhe vlerësimin të provave në shkresat e lëndës, u konstatua se Kërkesa për Rishqyrtim e Ankuesit është pjesërisht e bazuar.

Prandaj A.K. këto pretendime i konsideron pjesërisht si të qëndrueshme, dhe çështjet e ngritura do t'i marrë në rishqyrtim gjatë procesit të rivlerësimit të tenderit në fjalë.

**Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë
K.R.. nr. 070/2023, datë 13.10.2023**

Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik



Alban Tahiraj

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtrij Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Vendimi i dërgohet nga një kopje:

1. Palës/ ve;
2. DPP-së, dhe
3. Arkivit.